



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

**Drejtoria e Bujqësisë**

## **THIRRJE PËR APLIKIM**

**Përkrahje për pjesëmarrje me produkte bujqësore në Tregun mobil.**

Ftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës, të cilët janë prodhues të produkteve bujqësore, të aplikojnë për pjesëmarrje në tregun mobil të Komunës së Prishtinës.

### **Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:**

- Fermeri duhet të jetë prodhues i produkteve bujqësore;
- Përparësi do të kenë fermerët e komunës së Prishtinës, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e komunës së Prishtinës;
- Fermerët me shumëllojshmëri më të madh të prodhimeve bujqësore kanë përparësi;
- Në kushte të barabarta, gratë fermerë dhe grupet e marginalizuara kanë përparësi;
- Fermerët pa asnjë anëtarë të familjes të punësuar;
- Madhësia e fermës;
- Fermerët të cilët bujqësinë e kanë aktivitet parësor në të hyra familjare;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk e kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë tokë më qira, duhet të kenë marrëveshjen kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët.

### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë për vitin 2021;
- Marrëveshja në mes palëve për parcelat e marra me qira.

## **VËREJTJE**

Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë, të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, është i obliguar që t'i sjellë ato në afatin i cili i caktohet, në të kundërtën humb të drejtën për të qenë përfitues i subvencionit (grantit).

**Data e aplikimit, prej 11.03.2022 deri më 21.03.2022.**